

V E N D I M
Nr. 658, datë 18.12.2002

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES ME KONCENSION, NË FORMËN “ROT”,
TË HIDROCENTRALEVE VENDORE LENIE, ÇOROVODË, TUÇEP**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 e 9 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë”, të nenit 2 të ligjit nr. 8527, datë 23.9.1999 “Për privatizimin e hidrocentraleve vendore”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të hidrocentraleve vendore shoqërisë “EMIKEL”, sh.p.k., Elbasan, sipas propozimit të pakërkuar, si më poshtë vijon:

- Lenie, në rrethin e Gramshit;
- Çorovodë, në rrethin e Skraparit;
- Tuçep, në rrethin e Bulqizës.

2. Forma e koncesionit të jetë “ROT” (rehabilitim, operim, transferim).

3. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë të jenë organi shtetëror i autorizuar (OSHA) për negociimin dhe nënshkrimin e kontratës koncesionare.

Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano